



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

**UDHËZIM**

Nr. 8, datë 31 / 12 / 2020

**PËR**

**KRITERET, RREGULLAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR LËSHIMIN E LICENCAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE<sup>1</sup>.**

**Mbështetur në:** nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; VKM nr. 538, datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; VKM nr. 325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuar për këta operatorë”, të ndryshuar;

**Duke përshtatur:** rregulloret, direktivat dhe vendimet e Bashkimit Evropian, si dhe rezolutat e Forumit Ndërkombëtar të Transportit (ECMT/ CEMT) dhe të Kombeve të Bashkuara të zbatueshme në transportin rrugor të mallrave;

**Me qëllim:** rregullimin, disiplinimin dhe monitorimin e veprimtarisë që kërkohet të ushtrohet ose që ushtrohet nga subjekte në fushën e transportit rrugor, si dhe integrimin e plotë të tyre në tregun Evropian të transportit rrugor, zhvillimin në mënyrë harmonike të rregullave të transportit rrugor të mallrave, zbatimin e legjislacionit social e të sigurisë dhe mbrojtjen e ambientit, nevojën për të standardizuar dhe lehtësuar procedurat administrative, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë nxjerr këtë udhëzim.

---

<sup>1</sup> Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE”, (OJ L 300, 14.11.2009, faqe 51-71), amenduar me Rregulloren e Komisionit (BE) nr.613/2012, datë 09.07.2012, (OJ L 178, f. 6, datë 10.07.2012) dhe Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 517/2013, datë 13.05.2013, (OJ L 158, f. 1, datë 10.06.2013);

- Rregulloren (KE) nr. 1072/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 21 tetor 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të mallrave”, (OJ L 300, datë 14.11.2009, f. 72), ndryshuar me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 612/2012, datë 09.07.2012, (OJ L 178, datë 10.07.2012, f. 5) dhe Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 517/2013, datë 13.05.2013, (OJ L 158, datë 10.06.2013, f. 1);

- Direktivën 2006/1/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 janar 2006 mbi përdorimin e mjeteve me qira pa drejtues mjeti për transportin rrugor të mallrave, (OJ L 33, 4.2.2006, p. 82–85).

# KAPITULLI I

## QËLLIMI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

### 1. Qëllimi

Ky udhëzim përcakton kriteret, rregullat dhe procedurat që kërkohen për trajtimin në përputhje me dispozitat ligjore, të aplikimeve sipas dokumentacionit provues të paraqitur nga subjekte të regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, për lëshimin, pezullimin apo heqjen e licencave dhe certifikatave në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe përcaktimin e rregullave të aplikueshme për hyrjen në treg, si dhe përcaktimin e kushteve nën të cilat transportuesit rezidentë mund të kryejnë shërbime të transportit. Këto rregulla duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në funksionimin normal të tregut të transportit.

### 2. Fusha e zbatimit

2.1. Ky udhëzim aplikohet për të gjithë subjektet, të themeluar/ vendosur në Shqipëri, të angazhuar ose që synojnë të angazhohen në veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, ose për llogari të vet. Transporti nga subjektet e huaja që kanë si destinacion apo kalojnë tranzit nëpër territorin shqiptar, kryhet bazuar në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, palë në marrëveshje.

Transporti ndërkombëtar rrugor i mallrave të rrezikshme kryhet mbështetur në ligjin nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2.2. Licencimi është i detyrueshëm për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit ndërkombëtar rrugor për të tretë ose me qira.

2.3. Llojet e mëposhtme të transportit dhe udhëtimet bosh të kryera lidhur me të tilla transporte nuk kërkojnë pajisjen me licencë dhe janë të përjashtuara nga çdo autorizim/ leje transporti:

- a) transporti i postës si shërbim universal;
- b) transporti i mjeteve që kanë pësuar dëme ose shkatërrime;
- c) transporti i mallrave në mjete, masa e lejuar me ngarkesë, e cila, duke përfshirë atë të rimorkiove, nuk i kalon 3.5 ton.
- d) transporti për llogari të vet të mallrave, me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - i) mallrat e bartura janë pronë e subjektit ose janë shitur, blerë, lënë ose marrë me qira ose, prodhuar, nxjerrë, përpunuar ose riparuar nga ndërmarrja;
  - ii) qëllimi i udhëtimit është të transportojë mallrat në ose nga ndërmarrja ose të lëvizë ato brenda ose jashtë ndërmarrjes për kërkesat e veta;
  - iii) mjetet motorike të përdorura për një transport të tillë drejtohen nga personeli i punësuar ose vënë në dispozicion të ndërmarrjes nën një detyrim kontraktual;
  - iv) mjetet që transportojnë mallrat janë në pronësi të ndërmarrjes, janë blerë me këste ose janë marrë me qira, me kusht që në rastin e fundit të plotësojnë kushtet e Direktivës 2006/1/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 18 janar 2006 mbi përdorimin e mjeteve të marra me qira pa drejtues mjeti për transportin rrugor të mallrave;
  - v) një transport i tillë nuk është më shumë se ndihmës për aktivitetet e përgjithshme të ndërmarrjes.

- e) transportin e produkteve mjekësore, aparaturave, pajisjeve dhe artikujve të tjerë të nevojshëm për kujdes mjekësor në raste emergjente, veçanërisht për fatkeqësitë natyrore.

Shkronja d), iv) më lart nuk do të zbatohet për përdorimin e mjetit zëvendësues gjatë një avarie të shkurtër të mjetit të përdorur normalisht.

### 3. Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, të ndryshuar dhe në VKM nr. 325, datë 19.03.2008, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë udhëzim, ndërsa termat që përdoren në tekstin e këtij udhëzimi, kanë kuptim si më poshtë:

3.1. **Autoritet kompetent** nënkupton organin, i cili ka autoritetin ose i është deleguar autoriteti për lëshimin, pezullimin dhe heqjen e licencave/ certifikatave.

3.2. **ADR** nënkupton Marrëveshjen Europiane mbi transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme.

3.3. **Certifikatë:** dokument që mbahet në një mjet rrugor me motor dhe i jep të drejtën e operimit në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet.

3.4. **Drejtues mjeti**, nënkupton çdo person që drejton mjetin, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, ose që ndodhet në mjet si pjesë e detyrave të tij, për të qenë në dispozicion për drejtim mjeti, nëse është e nevojshme.

3.5. **Spektori/ specialisti përgjegjës**, nënkupton një trupë të posaçme, që është përgjegjëse për shqyrtimin dhe përgatitjen e materialeve për lëshimin e licencave, certifikatave, etj, sipas procedurave të brendshme të përcaktuara nga autoriteti kompetent.

3.6. **Kritere të licencimit** janë pjesë e kushteve dhe dispozitave ligjore, nga përmbushja e të cilave bazohet dhënia e licencës.

3.7. **Leje/ Licencë ECMT (CEMT)** nënkupton leje transporti ndërkombëtar multilateral shumë udhëtimesh dhe për një periudhë të caktuar kohe, për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave ndërmjet dy e më shumë shteteve anëtare të Forumit të Transportit Ndërkombëtar (ITF).

3.8. **“Mjet”** nënkupton një mjet me motor, një trailer/ rimorkio, një gjysmë-rimorkio ose një kombinim të mjeteve të destinuara ekskluzivisht për transport mallrash;

3.8.1. **Mjete motorike kategoria N:** mjete me motor të destinuara për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota:

- **Kategoria N2** janë mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më shumë se 12 tonë;
- **Kategoria N3** janë mjete të destinuara për transport mallrash, me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 12 tonë.

3.8.2. **Rimorkio kategoria O**, janë rimorkiot (përfshirë edhe gjysmë-rimorkiot):

- kategoria O1: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 0,75 tonë;
- kategoria O2: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 0,75 tonë, por jo më të madhe se 3,5 tonë;
- kategoria O3: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 3,5 tonë, por jo më të madhe se 10 tonë;
- kategoria O4: rimorkio me peshë maksimale me ngarkesë më të madhe se 10 tonë.

3.9. **Mjet me qira** nënkupton çdo mjet, i cili kundrejt shpërblimit dhe për një periudhë të caktuar kohe, vihet në dispozicion të një subjekti që angazhohet në transportin rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, ose për llogari të vet në bazë të një kontrate me personin juridik ose fizik që vë mjetin/ et në dispozicion.

3.10. **Operacion kabotazhi** nënkupton transportin për të tretë ose me qira, që kryhet midis dy pikave të ndryshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë në baza të përkohshme nga mjeti/ mjetet e një subjekti të huaj, i cili është regjistruar në një shtet tjetër.

3.11. **Pala kontraktuese** nënkupton atë shtet që ka dhënë dakordësinë/ pëlqimin për kryerjen e veprimtarisë së transportit, sipas marrëveshjeve dypalëshe, për aq kohë sa kjo marrëveshje është në fuqi.

3.12. **Regjistri Elektronik Kombëtar (REK)** është regjistri ku mbahen/ regjistrohen të dhënat për subjektet e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet për gjithë Shqipërinë.

3.13. **Subjekt** nënkupton çdo person juridik ose fizik tregtar, si edhe çdo term tjetër të përdorur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi si operatorë transporti, ndërmarrje transporti, transportues, etj., që ushtron veprimtarinë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave.

3.14. **Shkelje serioze** e legjislacionit të transportit rrugor nënkupton një shkelje që mund të çojë në humbjen e reputacionit të mirë në përputhje me VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar dhe nenin 6, pikat 1) dhe 2) dhe Aneksit IV të Rregullores (KE) nr. 1071/2009 dhe/ ose tërheqje të përhershme të licencës.

3.15. **Transport ndërkombëtar** nënkupton një udhëtim:

a) me ngarkesë i ndërmarrë nga një mjet, pika e nisjes dhe pika e mbërritjes së të cilit janë në dy shtete të ndryshme, njëri prej të cilëve është shteti palë në marrëveshje, me ose pa tranzit nëpërmjet një ose më shumë shteteve/ vendeve të treta.

b) me ngarkesë i ndërmarrë nga një mjet drejt një shteti palë në marrëveshje ose në një vend të tretë dhe anasjelltas, me ose pa tranzit nëpërmjet një ose më shumë shteteve ose vendeve të treta.

c) me ngarkesë i ndërmarrë nga një mjet ndërmjet vendeve të treta, me transit përmes territorit të Shqipërisë; ose

d) pa ngarkesë në lidhje me transportin e përmendur në shkronjat a), b) dhe c).

3.16. **Transportues jo-rezident** nënkupton një subjekt të transportit rrugor i regjistruar në një vend tjetër, palë në marrëveshje.

3.17. **Transit** nënkupton pjesën e udhëtimit përmes territorit të një vendi, në të cilin nuk ngarkohen apo shkarkohen mallra.

3.18. **Transport për llogari të vet** nënkupton transportet e kryera për qëllime jo tregtare dhe pa qëllim fitimi, nga një subjekt, me kusht që:

a) transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse për subjektin.

b) mjetet e përdorur të jenë pronë e subjektit, apo të jenë blerë me këste nga këto të fundit ose të jenë objekt i një kontrate qiramarrje afatgjatë dhe të drejtohen nga një punonjës i subjektit.

3.19. **Vendi i tretë** është vendi i cili nuk është anëtar i sistemit të kuotave CEMT, dhe/ ose nuk është palë e një marrëveshje dypalëshe.

3.20. **Vendi regjistrimit** është vendi ku është regjistruar mjeti, i cili shquhet edhe në targën e mjetit.

## KAPITULLI II

### PARIME TË PËRGJITHSHME DHE AUTORITETET KOMPETENTE PËR LËSHIMIN E LICENCËS/ CERTIFIKATËS

#### 4. Parime të përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave

4.1. Ushtrimi i veprimtarisë në transportin rrugor, sikundër përcaktohet në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bazohet në parimet:

- a) e proporcionalitetit, deburokratizimit dhe uljes së barrierave administrative.
- b) e interesave publikë që ato garantojnë dhe mund të jenë: aftësi profesionale apo fizike, përvojë apo njohuri, mënyrë organizimi, zotërimi i një teknike apo teknologjie të caktuar, gjendje apo garanci pasurore, gjendje juridike apo norma të sjelljes e të etikës.

4.2. Transporti ndërkombëtar rrugor i mallrave rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe në fushën e transportit rrugor, marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë dhe *acqui* të BE-së. Ky lloj transporti mund të jetë i lirë, pa leje/ autorizim, ose i shoqëruar me leje/ autorizim, me shtetin përkatës me të cilin do të kryhet transporti dhe/ ose transiti.

4.3. Kabotazhi apo transporti i mallrave ndërmjet dy pikave në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një transportues i huaj nuk lejohet, me përjashtime të veçanta dhe me leje të posaçme të ministrit, sipas përcaktimeve të VKM nr. 101, datë 9.2.2011, “Për miratimin e rregullave për lejet e transportit dhe kryerjen e operacioneve të transportit nga transportuesit e huaj, që nuk kanë selinë në Shqipëri (jorezidentë), për mallra dhe udhëtarë”.

#### 5. Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/ certifikatës në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave

| <i>Lloji i Veprimtarisë</i>   | <i>Dokumenti</i>   | <i>Autoriteti Kompetent</i>   | <i>Baza ligjore</i>  |
|---|--|---|--|
| Transport ndërkombëtar rrugor i mallrave për të tretë ose me qira   | Licencë  | Qendra Kombëtare e Bisnesit (QKB)                                     | Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009, të ndryshuar;<br><br>VKM nr. 538, datë 26.05.2009, të ndryshuar. |
| Transport dypalësh, shumëpalësh dhe për vende të treta (ECMT/ CEMT) | Licencë/Libri i udhëtimit, (karneti).  | Shoqata Kombëtare e Transportuesve Ndërkombëtarë Rrugorë, (ANALTIR)   | Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998<br>“Për transportet rrugore”, të ndryshuar.                        |
|   | Certifikatë e përputhshmërisë me kërkesat teknike dhe të sigurisë për mjete EURO | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) | Udhëzuesi/ Guida e përdorimit ECMT/ CEMT, janar 2014.  |
| Transport ndërkombëtar rrugor për llogari të vet                    | Certifikatë  | DPSHTRR   | Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998  |
| Transport ndërkombëtar rrugor i mallrave të rrezikshme              | Certifikatë  | DPSHTRR   | “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.   |

5.1. **Autoriteti kompetent**, është përgjegjës për të siguruar zbatimin korrekt të këtij udhëzimi dhe është i autorizuar për të:

- a) kontrolluar aplikimin e bërë nga subjekti.
- b) kontrolluar deklarin e një subjekti nëse është i përshtatshëm dhe i aftë si drejtues i veprimtarisë së një ndërmarrje transporti.
- c) kryer kontrollet e kërkuara për verifikimin nëse një subjekt kënaq kërkesat sipas pikës 6, të këtij udhëzimi dhe plotëson kushtet e përcaktuara në përputhje me rregullat për pranimin në profesionin e operatorit të transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave.
- d) lëshuar dokumente si: licencë/ certifikatë/ libër udhëtimi (karnetë) për subjekte të angazhuar në transportin rrugor të mallrave, dhe të pezullojë ose tërheqë/ anullojë këto dokumente.

### **KAPITULLI III KRITERET BAZË TË LICENCIMIT**

#### **6. Kriteret e licencimit, kërkesat bazë**

Për të ushtruar veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, e cila është subjekt licencimi/ certifikimi, subjektet paraqesin kërkesë pranë autoritetit kompetent, duke provuar se plotësojnë kriteret e posaçme sipas këtij udhëzimi, kreut II.1 të VKM nr. 325, datë 19.03.2008, të ndryshuar dhe të reflektuara edhe në aneksin 1, të VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009, të ndryshuar që janë:

- një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri;
- reputacioni i mirë;
- qëndrueshmëria financiare;
- kompetenca profesionale.

#### **6.1 Një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri**

Për të kënaqur kërkesën e plotësimit të këtij kriteri, një subjekt duhet të:

- a) ketë vendndodhjen në Shqipëri me ndërtesën/ ambientin, në të cilin ai mban dokumentet e veprimtarisë së tij, në veçanti dokumentet e tij financiare dhe të menaxhimit të personelit, dokumente që përmbajnë të dhëna lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit të drejtuesit/ drejtuesve të mjetit/ mjeteve, si dhe çdo dokument tjetër për të cilin autoritetet e ngarkuara me ligj për kontrollin e dokumentacionit duhet të kenë akses, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kushtet e përcaktuara në këtë udhëzim dhe aktet e tjera ligjore.
- b) ketë në dispozicion të tij një ose më shumë mjete, të cilët janë regjistruar ose janë vënë në qarkullim në përputhje me legjislacionin shqiptar, nëse këto mjete janë në pronësi ose janë nën një marrëveshje/ kontratë qira-marrje ose një kontrate qira-blerje, me këste.
- c) drejtojë efektivisht dhe vazhdimisht me procedurat e nevojshme administrative operacionet lidhur me mjetet të përmendur në pikën 9 dhe me pajisje të përshtatshme teknike dhe ambientet e një qendre operimi të vendosur në Shqipëri.

## 6.2 Reputacioni i mirë

Subjekti konsiderohet me reputacion të mirë kur plotëson kërkesat e VKM nr. 325, datë 19.03.2008, të ndryshuar.

6.2.1 Çdo subjekt, që kërkon të ushtrojë veprimtari në transport ndërkombëtar rrugor të mallrave, duhet të deklarojë se plotëson kushtin e reputacionit të mirë nëpërmjet plotësimit të formularit të vetëdeklarimit nga përfaqësuesi ligjor dhe drejtuesi i veprimtarisë.

6.2.2 Autoriteti kompetent mund të verifikojë rast pas rasti deklaratën/ deklaratat e plotësimit të kushtit të reputacionit të mirë.

6.2.3 Referuar pikës 6.2.4 më poshtë, autoriteti kompetent përcakton kushtet për tu plotësuar nga subjektet dhe drejtuesit e veprimtarisë së transportit, me qëllim që të kënaqin kërkesat e reputacionit të mirë.

Çdo referencë në këtë pikë për dënimet, gjobat ose shkeljet do të përfshijë dënimet, gjobat ose shkeljet e vetë subjektit, të drejtuesve të veprimtarisë së transportit dhe çdo personi tjetër të përshtatshëm të përcaktuar nga autoriteti kompetent.

6.2.4. Referencat në paragrafin e mësipërm, përfshijnë të paktën kushtet si në vijim:

- a) nuk ka patur ngjarje detyruese për dyshim të reputacionit të mirë të drejtuesit të veprimtarisë të subjektit, të tillë si, dënimet ose gjobat për çdo shkelje serioze të legjislacionit dhe rregullave në fuqi në Shqipëri, përkatësisht:
  - i. ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar;
  - ii. ligjit nr. 8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin”;
  - iii. kushtet e punësimit dhe të pagesës në profesion;
  - iv. ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
  - v. përgjegjësinë profesionale;
  - vi. trafikimin e qenieve njerëzore ose drogave, dhe
- b) drejtuesi i veprimtarisë të subjektit nuk ka qenë i dënuar në të kaluarën për një veprim të rëndë kriminal ose të këtë pësuar një ndëshkim/ gjobitje për një shkelje serioze të rregullave në veçanti lidhur me:
  - i. kohën e drejtimit dhe periudhat e pushimit për drejtuesit e mjeteve, kohën e punës, si dhe instalimin dhe përdorimin e pajisjeve të regjistrimit;
  - ii. peshat dhe përmasat maksimale të mjeteve të përdorur në transportin ndërkombëtar;
  - iii. kualifikimin fillestar dhe trajnimin periodik të drejtuesve të mjeteve;
  - iv. kontrollet e mjeteve, përfshirë inspektimin teknik;
  - v. pranimin në veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave;
  - vi. instalimin dhe përdorimin e pajisjeve kufizuese të shpejtësisë në disa prej kategorive të mjeteve;
  - vii. lejet e drejtimit;
  - viii. transportin e kafshëve.

6.2.5 Për qëllime të pikës 6.2, nëse drejtuesi i veprimtarisë së transportit ose subjekti ka qenë dënuar për një shkelje serioze kriminale ose ka pësuar një ndëshkim për një nga shkeljet serioze sipas Lidhjes 4, autoriteti kompetent do të kryejë në mënyrë dhe në kohë të

përshtatshme një procedurë të plotë administrative, e cila do të përfshijë një kontroll në ambientet e subjektit përkatës.

Rezultati i kontrollit përcakton nëse në rrethana specifike të caktuara, humbja e reputacionit të mirë duhet të përbëjë një përgjegjësi personale. Çdo gjetje e tillë do të duhet të justifikohet. Kur autoriteti kompetent nuk gjen arsye/ shkak që humbja e reputacionit të mirë përbën një shkelje serioze, dënimi ose gjopa nuk do të shoqërohet me humbjen e reputacionit të mirë.

## **7. Qëndrueshmëria financiare**

Subjekti kënaq kriterin e qëndrueshmërisë financiare kur plotëson dispozitat e kreut II.1 të VKM nr. 325, datë 19.03.2008, të ndryshuar, konkretisht shkronja “a”, në pikën 5.2: “a) Jo më pak se 9000 euro, për mjetin e parë, dhe 5000 euro për çdo mjet shtesë, të autorizuar për t’u përdorur në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;”.

## **8. Kompetenca profesionale**

8.1. Subjekti konsiderohet se plotëson kërkesën në lidhje me kompetencën profesionale kur pronari/ administratori është i pajisur me certifikatën përkatëse të kompetencës profesionale (CKP) për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave, lëshuar nga:

a) DPSHTRR sipas Udhëzimit nr. 1, datë 28.01.2009, “Për pajisjen me certifikatën e kompetencës profesionale të drejtuesit të veprimtarisë së operatorit të transportit rrugor”, të ndryshuar;

b) Shoqata Kombëtare e Transportuesve Ndërkombëtarë Rrugorë (ANALTIR)/ Instituti i Trajnimit ANALTIR, akredituar nga Akademia IRU (Bashkimi Ndërkombëtar i Transportit Rrugor), sipas programit të trajnimit të miratuar nga kjo Akademi dhe Kartës së Kualitetit (Quality Charter), për operacionet e transportit ndërkombëtar rrugor sipas Sistemit të Kuotave multilaterale ECMT/ CEMT, miratuar në takimin e Ministrave të Transportit të vendeve anetare të Forumit Ndërkombëtar të Transportit, mbajtur në Leipzig më 28 maj 2015.

8.2. Nëse pronari/ drejtuesi i veprimtarisë së subjektit nuk plotëson kërkesat në përputhje me kompetencën profesionale, subjekti do të caktojë një drejtues veprimtarie transporti sipas kërkesave të kreut II.1 të VKM nr. 325, datë 19.03.2008, të ndryshuar.

### **8.3 Drejtuesi i veprimtarisë së transportit**

8.3.1. Çdo subjekt duhet të:

- caktojë një drejtues veprimtarie në përputhje me dispozitat e kreut II.1 të VKM nr. 325, datë 19.03.2008, të ndryshuar;
- njoftojë brenda 15 ditëve autoritetin kompetent të lëshimit të licencës (QKB) për ndryshime të mundshme në kontraktimin e drejtuesit të veprimtarisë, dhe brenda 30 ditëve paraqitet në QKB për të kryer ndryshimet e nevojshme.

8.3.2. Personat që punojnë në organet e transportit ose të varësisë, në QKB, ose në organet e kontrollit në rrugë sipas nenit 12, të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, që mbulojnë veprimtarinë e transportit rrugor dhe që janë të pajisur me certifikatën e kompetencës profesionale, nuk lejohen të ushtrjnë veprimtarinë e tyre si drejtues veprimtarie në një subjekt. Shmangia nga ky rregull përbën shkelje të reputacionit të drejtuesit të veprimtarisë dhe shkak për heqjen e certifikatës së kompetencës profesionale.



## **9. Gjendja e përshtatshme e mjeteve**

9.1. Gjendja e përshtatshme e mjeteve, provohet nëpërmjet plotësimit të standardeve të sigurisë rrugore dhe standardeve të zhurmave dhe të ndotjes së ambientit.

9.2. Autoriteti kompetent për lëshimin e licencës/ certifikatës në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që subjektet mund të përdorin për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, në të njëjtat kushte mjetet në pronësi të tyre dhe mjetet me qira, të regjistruara ose të vendosura në qarkullim në përputhje me ligjet në fuqi, me kusht që janë plotësuar/ kënaqur kushtet e përcaktuara në pikën 9.4.

9.3. Për të ushtruar veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, për shërbimet për llogari të vet, mjetet duhet të jenë të pajisur me certifikatën për veprimtarinë përkatëse, lëshuar në emër të subjektit. Certifikatat lëshohen vetëm kur plotësohet kërkesa për gjendjen e mirë të mjeteve në përputhje me standardet e kërkuara.

### **9.4. Mjetet me Qira**

9.4.1. Për qëllime të transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet, ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve palë në marrëveshje dypalëshe, ose dhe shumëpalëshe, kuotave multilaterale ECMT/ CEMT, apo edhe në vende të treta, lejohet për përdorim brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, mjet i marrë me qira, duke siguruar që:

- a) mjeti është regjistruar ose vendosur në qarkullim në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- b) kontrata lidhet vetëm për marrjen me qira të mjetit pa drejtues mjeti dhe nuk shoqërohet nga një kontratë shërbimi e përfunduar me të njëtin subjekt, që mbulon personelin e drejtimit ose shoqërimin.
- c) mjeti i marrë me qira është në dispozicion të subjektit që e përdor atë gjatë periudhës së kontratës së qirasë.
- d) mjeti i marrë me qira drejtohet nga personeli i subjektit që e përdor atë.
- e) qiramarrësi është përgjegjës për operimin në kushte të sigurta të mjetit të marrë me qira. Ai kryen kontrollin e duhura para përdorimit dhe mban regjistrimet e nevojshme për përdorimin e mjetit, përfshirë mirëmbajtjen e tij.
- f) qiramarrësi është përgjegjës për sigurimin e dokumenteve që duhet të mbahen në mjet, si më poshtë:
  - i. kopjen certifikuar të licencës/ certifikatës;
  - ii. kopjen e kontratës midis qiramarrësit dhe qiradhënësit, ose një dokument të barasvlefshëm me të, duke dhënë në mënyrë të veçantë emrin e qiradhënësit, emrin e qiramarrësit, datën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe identifikimin e mjetit.

9.4.2. Një subjekt mund të marrë me qira një mjet nga një subjekt tjetër për një periudhë të përkohshme, në përputhje me afatet dhe mënyrat e përcaktuara si më poshtë:

- i. Subjekti mund të marrë me qira, me ose pa drejtues, një mjet transporti për rastin e mjeteve të prishur apo mjeteve që janë për riparim. Qiramarrja e mjetit mund të bëhet për aq kohë sa subjekti e sheh të arsyeshme, por jo më shumë se 3 muaj;
- ii. Në këtë rast, certifikata e vjetër për shërbimet për llogari të vet me të dhënat e qiradhënësit, dorëzohet pranë autoritetit kompetent dhe për këtë mjet lëshohet certifikata e re me të dhënat e qiramarrësit;

Nuk lëshohet certifikatë e re për qiramarrësin nëse nuk dorëzohet certifikata e vjetër nga qiradhënësi;

- iii. Në raste emergjence civile, etj., ose piku të paparashikuar të kërkesës për transport, një subjekt i pajisur me licencë merr me qira një mjet, me ose pa drejtues mjeti, për një periudhë deri sa zgjat ose është shpallur emergjenca ose piku. Subjekti qiramarrës duhet të regjistrojë mjetin pranë QKB-së;
- iv. Mjeti i marrë me qira duhet të jetë në përputhje me dispozitat e pikës 9, të këtij udhëzimi.

## **KAPITULLI IV**

### **PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E LICENCAVE/ CERTIFIKATAVE**

#### **10. Dorëzimi, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave**

10.1. Subjektet që dëshërojnë të ushtrojnë veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave, paraqesin kërkesën (sipas Lidhjes 1), të shoqëruar me dokumentet provuese (një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri, reputacioni i mirë, qëndrueshmëria financiare, kompetenca profesionale), të cilat dorëzohen pranë autoritetit kompetent sipas rregullave të përcaktuara.

Në rastin e aplikimit për licencë, dokumentet paraqiten pranë QKB-së, bazuar në nenin 31, seksioni VI i ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, të ndryshuar.

Aplikimi për licencë, së bashku me dokumentet që provojnë përmbushjen e kriterëve, pasi dorëzohen në QKB, sipas procedurave standarde, shqyrtohet brenda afateve kohore të miratuara, nga autoriteti kompetent. Akt-miratimi ose mos-miratimi për lëshimin e licencës mund të jepet vetëm në përgjigje të një aplikimi nëpërmjet QKB-së.

Kërkesat që kanë lidhje me aplikimet për pajisjen me certifikata në transportin ndërkombëtar rrugor, dorëzohen në zyrën e protokollit pranë autoritetit kompetent, nëpërmjet shërbimit me postë ose me postë elektronike.

10.2. Autoriteti kompetent, nëpërmjet sektorit/ specialistit përgjegjës, shqyrton aplikimet përkatëse.

10.2.1. Sektori/ specialisti përgjegjës, ka këto përgjegjësi dhe detyra:

- a) Në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe rregulloret në zbatim të tij, merr në dorëzim nga zyra e protokollit ose sistemit me postë elektronike dhe administron të gjitha aplikimet për licencim/ certifikim, etj.
- b) Regjistron në regjistra të posaçëm në formë shkresore dhe elektronike çdo aplikim të ndarë sipas objektit: licencim/ certifikim për herë të parë, rinovim, kërkesa për licencë të certifikuar, pezullim, lëshim dublikate, zëvendësim ose shtesë mjeti, etj.
- c) Kur aplikimi nuk shoqërohet me dokumentacionin provues, sipas këtij udhëzimi, sektori/ specialisti përgjegjës brenda 5 (pesë) ditëve pune nga marrja në dorëzim, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, i komunikon me shkrim aplikuesit kërkesën për plotësim dokumentacioni, me shënimet përkatëse. Komunikimi me shkrim pezullon afatet e shqyrtimit të kërkesës.
- d) Materiali për shqyrtimin e kërkesave nga subjektet që aplikojnë për t’u pajisur me licencë (nëpërmjet QKB-së), përgatitet nga sektori/ specialisti përgjegjës për licencimin dhe vetëm për ato subjekte, të cilët kanë plotësuar dokumentacionin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Materiali duhet të jetë i plotë dhe të pasqyrojë me hollësi të gjithë elementët e nevojshëm sipas veprimtarive përkatëse.

- e) Kur aplikimi rezulton të jetë i plotë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 10 ditëve pune nga marrja në dorëzim e kërkesës sipas shkronjës “a” të kësaj pike, shqyrton kërkesën dhe përgatit materialin përkatës, i cili kthehet në vendim dhe miratohet nga titullari i autoritetit ose personi i autorizuar prej tij.
- f) Mbi bazën e vendimit, rast pas rasti, përgatiten shkresat përcjellëse dhe/ose në rrugë elektronike i përcillen QKB-së për miratimin ose mos-miratimin për aplikimet e paraqitura nga ana e subjekteve për pajisje me licencë për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, sipas kërkesave përkatëse.
- g) Përgatit formatet e licencave/ certifikatave sipas standardeve të miratuara, (Lidhja 5 dhe Lidhja 6), një kopje të licencës origjinale për çdo subjekt të licencuar, e cila mbahet në zyrën e subjektit, dhe aq kopje të certifikuara të licencës sa është numri i mjeteve të paraqitura në aplikim. Kopja/ kopjet e/ të certifikuar/ a të licencës ka/ kanë të njëjtin numër lëshimi si licenca origjinale, por me numër serial të ndryshëm, e cila/ të cilat regjistrohen në REK.

10.2.2. Dokumentet për rinovimin e licencave dhe certifikatave, paraqiten jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së tyre.

10.2.3. Praktikrat arkivohen në bazë të veprimtarive përkatëse sipas rendit alfabetik të subjektit/ve, duke mbajtur shënimet e plota, të arkivimit dhe dorëzimit të tyre. Dokumentacioni ruhet nga sektori/ specialisti përgjegjës për një periudhë 3 vjeçare dhe më pas dorëzohet në arkivin qendror të autoritetit kompetent.

10.2.4. Sektori/ specialisti përgjegjës nuk duhet të kërkojë paraqitjen e dokumenteve apo dhënien e informacioneve të tjera, të paparashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë procesin e licencimit. Dokumentet provuese, (në origjinal ose të njehsuara me origjinalin), që janë paraqitur gjatë një aplikimi të mëparshëm dhe janë brenda afatit të vlefshmërisë nuk kërkojnë të paraqiten për një aplikim të ngjashëm për të njëjtën veprimtari. Sektori/ specialisti përgjegjës pranon dokumentet provues për trajtim edhe/ ose kopje.

10.2.5. Afati për shqyrtimin dhe marrjen e një vendimi për aplikimet nëpërmjet QKB-së është 10 ditë pune, në përputhje me VKM nr. 1295, datë 29.12.2009, që ndryshon VKM nr. 538, datë 26.05.2009. Në rastet kur bëhet e pamundur marrja e një vendimi aplikohet shtyrja e shqyrtimit të kërkesave sipas procedurave të QKB-së, por jo më shumë se një herë dhe jo më shumë se 10 ditë pune. Në rast të kundërt aplikohet miratimi në heshtje.

10.2.6. Sektori/ specialisti përgjegjës për procedurat e licencimit duhet të:

- a) kërkojë çdo fillim viti informacion të detajuar nga organet e kontrollit në pikat e kalimit të kufirit, mbi operimin e subjekteve të pajisura me licencë për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, ku të jepen të dhëna mbi mjetin, kapacitetin, llojin e ngarkesës të transportuar dhe destinacionin.
- b) krijojë një regjistër elektronik, me qëllim hedhjen/ grumbullimin e të dhënave për:
  - subjektet të pajisura me licencë për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave;
  - numrin e subjekteve dhe mjeteve që kalojnë sipas pikave kufitare;
  - shkeljet e konstatuara nga organet e kontrollit vendas dhe të huaj ndaj subjekteve shqiptare, lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tyre në përputhje me dispozitat e përcaktuara në licencë, kohën e drejtimit dhe të pushimit të drejtuesit të mjetit, etj.
- c) dërgojë informacion për regjistrimin në REK dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë për subjektet e pajisura me licencë dhe certifikatë për llogarit e vet për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, në zbatim të Udhëzimit nr. 328, datë 20.1.2017 “Mbi rregullat e hollësishme për listën e të dhënave që mbahen

në regjistrin elektronik kombëtar të transportit rrugor, si dhe modalitetet e mbajtjes së tij”.

10.2.7. Autoriteti kompetent i licencimit ka detyrimin:

- a) të verifikojë deklaratën në plotësimin e kushtit të reputacionit të mirë për subjektin dhe drejtuesin e veprimtarisë së saj.
- b) të verifikojë plotësimin në vazhdimësi të kushteve të licencimit për çdo subjekt transporti të licencuar prej tij.
- c) të dërgojë të gjithë të dhënat në lidhje me licencat ose certifikatat për llogari të vet, si edhe ndryshimet që mund të ndodhin më pas, brenda 7 ditëve pune, tek DPSHTRR, që bazuar në Udhëzimin nr. 328, datë 20.1.2017 është mbajtësi i regjistrit elektronik kombëtar (REK).

## **11. Formatet e licencave dhe certifikatave, nënshkrimi dhe data lëshimit**

11.1. Licenca/kopjet e certifikuara lëshohen sipas formatit të miratuar, mbështetur në modelin e Rregullores (KE) 1072/2009, përcaktuar edhe në këtë udhëzim, përkatësisht sipas Lidhjes 5. Kopja e certifikuar e licencës, pavarësisht kohës së aplikimit lëshohet nga autoriteti kompetent me afat sa afati i licencës origjinale.

11.2. Certifikata e mjeteve për llogari të vet lëshohet bazuar në pikën 3.18, b) të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, sipas formatit të Lidhjes 6 dhe nënshkruhet nga titullari i autoritetit kompetent dhe/ ose personi i deleguar/ caktuar prej tij.

11.3. Data e lëshimit të licencës/ kopjes së certifikuar ose certifikatës është data e nënshkrimit të tyre.

11.4. Licenca/ kopjet e certifikuara dhe certifikatat janë objekt i pagesës në llogarinë e autoritetit kompetent që i lëshon ato, në bazë të tarifave të miratuara:

- për licencat sipas VKM nr. 1035, datë 09.07.2008 “Për caktimin e tarifës së licencimit të subjekteve, nga M.P.P.T.&T., në fushën e punimeve të ndërtimit dhe transportit, të ndryshuar. (VKM nr. 1123, datë 13.11.2009);
- për certifikatat e mjeteve për llogari të vet dhe certifikatat e mjeteve për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas shkresës nr. 13786/1, datë 27.01.2010, të ministrisë përgjegjëse për financat.

Të ardhurat që grumbullohen shënohen në një regjistër të veçantë.

## **KAPITULLI V**

### **KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE**

#### **12. Dokumentet që kërkohen për t’u pajisur me licencë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira**

12.1. Licenca për ushtrim veprimtarie në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, lëshohet për subjektet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, të reflektuara edhe në aneksin 1, kategoria VII.2 të VKM-së nr. 538, datë 26.05.2009, të ndryshuar.

12.2. Licenca për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira jep edhe të drejtën për transport rrugor mallrash brenda vendit për të tretë ose me qira.

12.3. Subjekti i paraqet autoritetit kompetent kërkesën sipas Lidhjes 1, e cila duhet të përmbajë:

- Llojin e veprimtarisë që kërkohet të kryhet;
- Të dhëna për identifikimin e kërkuesit dhe të personit që paraqet kërkesën;
- Adresën e plotë të selisë/ filialit për ushtrimin e veprimtarisë;
- Dokumentin që vërteton se subjekti ka në pronësi, të paktën një mjet të përshtatshëm për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, (targën/ targat e mjeteve që do përdoren) të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB), shoqëruar me NUIS dytësor, (certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm);
- Regjistrimi në QKB, (ekstrakti i QKB-së), ku në objektin e veprimtarisë të shprehet aktiviteti, transport ndërkombëtar rrugor i mallrave për të tretë ose me qira;
- Plotësimi i kriterit të reputacionit të mirë për përfaqësuesin ligjor dhe/ ose pronarin/ pronarët e subjektit, si dhe për drejtuesin e veprimtarisë, që provohet me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, përkatësisht sipas modeleve të Lidhjes 3 dhe 3/1;
- Dokumenti që vërteton zotërimin e kompetencës profesionale (ÇKP), për personin që drejton veprimtarinë e transportit për subjektin që do të licencohet;
- Akt që vërteton marrëdhëniet e kërkuara të punës, (kontrata e punës) lidhur ndërmjet përfaqësuesit ligjor të subjektit dhe drejtuesit të veprimtarisë në rastet kur subjekti nuk plotëson kërkesën e kompetencës profesionale;
- Dokumenti i qëndrueshmërisë financiare;
- Lista e dokumenteve shoqëruese që duhen paraqitur.

### 13. Lejet multilaterale ECMT/ CEMT

13.1. Licenca për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave është kusht paraprak për lëshimin e lejeve multilaterale ECMT/ CEMT, bazuar në kuotat ECMT/ CEMT.

13.2. Pas pajisjes me licencë, subjekti aplikon pranë ANALTIR për t'u pajisur me leje CEMT, e cila lëshohet vetëm për subjekte me eksperiencë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, jo më pak se 2 (dy) vjet.

Bazuar në "Kuota shumëpalëshe CEMT, Udhëzuesi/ Guida e Përdorimit", janë të detyrueshme të përdoren certifikatat e prodhuara sipas Aneksëve 2, 4, 5 dhe 6 të kësaj guide, si më poshtë:

- a) Certifikata CEMT e përputhshmërisë me kërkesat teknike dhe të sigurisë për mjete EURO. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i mjetit ose nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit, sipas Aneksit 4 të guidës, *(nga dhjetor 2012)*;
- b) Certifikata CEMT e përputhshmërisë e rimorkios me kërkesat teknike të sigurisë, sipas Aneksit 5, të guidës, *(nga janar 2014)*;
- c) Certifikata CEMT e kontrollit teknik për mjetet motorike dhe rimorkiot për mjete EURO. Kjo certifikatë lëshohet nga prodhuesi i mjetit, nga përfaqësuesi i autorizuar prej tij në vendin e regjistrimit të mjetit, ose nga DPSHTRR-ja, sipas Aneksit 6, të guidës, *(nga janar 2014)*. *Gjithashtu, nga 1 janari 2015, kjo certifikatë, sipas këtij aneksi, do të përdoret edhe për kamionët/ mjetet motorrike me peshë maksimale të lejuar me ngarkesë më të madhe se 3.5 tonë dhe nuk kalon 6 tonë.*
- d) Certifikata CEMT e përputhshmërisë për kamionët me peshë maksimale të lejuar me ngarkesë më të madhe se 3.5 tonë dhe nuk kalon 6 tonë, *(nga 1 janar 2015)*;
- e) Certifikata CEMT e përputhshmërisë për rimorkiot/ trajlerat me peshë maksimale të lejuar me ngarkesë që nuk kalon 3.5 tonë, me kërkesat teknike dhe të sigurisë, *(nga 1 janar 2015)*;

- f) Autorizimi CEMT për lëvizje ndërkombëtare/ transport ndërkombëtar pa ngarkesë, sipas Aneksit 2, të guidës, (nga 15 tetor 2019).

13.3. Libri i udhëtimit (karneti), duhet të jetë në gjuhën e vendit të regjistrimit me numra serial nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar, në të cilin përfshihen certifikatat në përputhje me dispozitat teknike që kanë të bëjnë me emetimin e gazrave dhe zhurmave dhe sigurinë që kërkohet për mjetet motorike, bazuar në guidën e sipërcituar.

Certifikatat do të kenë numër serial, në atë mënyrë që të formojnë një seri koherente. Autoriteti kombëtar mundet drejtëpësdrejtë të realizojë numërimin ose t'ia delegojë atë prodhuesit, por në të dy rastet autoriteti kombëtar do të jetë përgjegjës për t'u siguruar që numrat e certifikatave mund të "gjurmohen", pra çdo certifikatë mund të identifikohet;

13.4. Leja ECMT/ CEMT lëshohet bashkë me Karnetën, e cila përdoret për të kontrolluar përdorimin e lejes ECMT/ CEMT. Ajo mbahet në mjet bashkë me lejen.

13.5. Për të aplikuar sërish për lejen ECMT/ CEMT, subjekti duhet të dorëzojë në zyrën e ANALTIR, lejet e përdorura dhe karnetat. Subjektet, të cilët nuk i kanë përdorur lejet ECMT/ CEMT, janë të detyruara t'i kthejnë ato pranë ANALTIR, në të kundërt, humbasin të drejtën për t'u pajisur përsëri me leje, vitin pasardhës.

13.6. Lejet ECMT/ CEMT, të anuluar ose të kthyera të papërdorura nga një subjekt, u jepen, për periudhën e mbetur të vlefshmërisë, subjekteve të tjerë që kanë bërë kërkesë. Leja ECMT/ CEMT duhet të kthehet në zyrën përkatëse brenda 15 ditëve pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

#### **14. Transporti ndërkombëtar rrugor i mallrave të rrezikshme**

14.1. Veprimtaria e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme ushtrohet kundrejt certifikatës së mallrave të rrezikshme.

14.2. Certifikata lëshohet nga DPSHTRR për çdo subjekt, të pajisur paraprakisht me licencë për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira, që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme. Subjekti paraqet:

- a) Formulari i autodeklarimit (plotësuar dhe vulosur nga subjekti).
- b) Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit (QKB), i cili verifikohet nga nëpunësi i autorizuar i DRSHTRR-së.
- c) Leje e Qarkullimit për çdo mjet (mbahet fotokopje).
- d) Kontratë qiraje për mjetet me qira.
- e) Dokument identifikimi për aplikantin ose personin e pajisur me autorizim.
- f) Kontolli Teknik Periodik Vjetor, (mbahet fotokopje).
- g) Sipas Udhëzimit nr. 6, datë 27.5.2015 "Për procedurat e inspektimit të mjeteve, lëshimit të certifikatës së miratimit ADR, kushtet që duhet të plotësojë personi juridik për inspektimin e mjeteve ADR dhe tarifat e shërbimit":
  - i) Certifikatën e Aprovuar për Mjetet që Transportojnë Mallra të Rrezikshme të Caktuara (sipas ADR), lëshuar nga DPSHTRR-ja,
  - ii) Certifikatën e inspektimit të cisternës automobilistike për mallra të rrezikshme, (model 013), lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- h) çdo dokument që subjekti kërkues gjykon se është i dobishëm për shqyrtimin e kërkesës së tij.

14.3. Për rinovimin e certifikatës për transport mallrash të rrezikshme, kërkohen të njëjtat dokumente, sipas pikës 14.2 më lart.

## **15. Transporti ndërkombëtar i mallrave për llogari të vet**

15.1. Veprimtaria e transportit ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet ushtrohet me anë të certifikatës. Kjo certifikatë lëshohet nga DPSHTRR për subjekte fizike ose juridike.

15.2. Mjetet me një masë/peshë maksimale me ngarkesë deri në 1,5 tonë nuk certifikohen për veprimtarinë e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave për llogari të vet.

## **16. Dokumentacioni i nevojshëm për certifikim në transportin ndërkombëtar të mallrave për llogari të vet**

16.1. Subjekti paraqet pranë autoritetit kompetent:

- Kërkesën sipas formularit të vetëdeklarimit;
- Lejen e qarkullimi;
- Aktin e pronësisë mbi mjetin ose kontratën e qiramarrjes në emër të subjektit aplikues shoqëruar me regjistrimin në QKB;
- dokumentin e qëndrueshmërisë financiare;
- dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave ligjore në lidhje me standardet dhe sigurinë për mjetet;
- policë sigurimi se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar;
- certifikatën e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm;
- certifikatën e kalibrimit të tahogرافit;
- çdo dokument tjetër shoqëruar, i cili kërkohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial, me kusht që këto dokumente, janë publikuar në regjistrin informativ për kategorinë e licencës, sipas VKM nr. 538, datë 26.05.2009, të ndryshuar;
- çdo dokument që subjekti kërkues gjykon se është i dobishëm për shqyrtimin e kërkesës së tij.

16.2. Subjekti që kërkon pajisjen me certifikatë/a sigurohet që, çdo mjet i cili kryen një shërbim, duhet të mbajë gjatë gjithë udhëtimit një certifikatë ose kopjen e saj të certifikuar/ njehsuar me origjinalin/ noterizuar, e cila do t'i paraqitet organeve të kontrollit të autorizuar për inspektim, me kërkesën e tyre.

## **17. Lëshimi, pezullimi dhe heqja e licencës dhe certifikatës**

17.1 Lëshimi i licencës, certifikatës.

Licenca lëshohet kur aplikanti plotëson kushtet e Kapitullit III, pika 6.1 (një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri, reputacioni i mirë, qëndrueshmëria financiare, kompetenca profesionale).

Licenca/ certifikata nuk mund të transferohet nga mbajtësi (titullari) i saj tek një subjekt tjetër.

Kopja e certifikuar e licencës lëshohet me kërkesë të subjektit, i cili ka një licencë të vlefshme për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave dhe lëshohet një kopje për një mjet. Numri i kopjeve që lëshohen bazohet në numrin e mjeteve, të cilat janë regjistruar në emër të subjektit.

Në rastin e një çifti të kombinuar të mjeteve licenca duhet të shoqërojë mjetin motorik. Licenca mbulon kombinimin e mjeteve të shoqëruara edhe në qoftë se rimorkio ose gjysmë - rimorkio nuk është i regjistruar ose autorizuar të përdorë rrugët në emër të mbajtësit të licencës ose nëse është i regjistruar ose i autorizuar të përdorë rrugët në një shtet tjetër.

Licenca duhet t'u paraqitet çdo zyrtari inspektues të autorizuar, me kërkesë të tyre.

Në rastin kur kërkon të pajiset me kopje të certifikuar të licencës, për arsye të shtimit të një mjeti ose disa mjeteve, subjekti dorëzon dokumentet përkatëse si më poshtë:

- Kërkesën sipas formularit të vetëdeklarimit;
- Lejen e qarkullimit;
- Aktin e pronësisë mbi mjetin ose kontratën e qiramarrjes në emër të subjektit që zotëron licencën, shoqëruar me NUIS dytësor;
- dokumentin e qëndrueshmërisë financiare;
- dokumente që vërtetojnë përmbushjen e kërkesave ligjore në lidhje me standardet dhe sigurinë për mjetet;
- policën e sigurimit se pronari/ përdoruesi i mjetit të transportit ka lidhur kontratën e sigurimit, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, të ndryshuar;
- certifikatën e kryerjes së kontrollit teknik të detyrueshëm;
- certifikatën e kalibrimit të tahografit;
- çdo dokument tjetër shoqërues, i cili kërkohet sipas legjislacionit të posaçëm sektorial, me kusht që këto dokumente, janë publikuar në regjistrin informativ për kategorinë e licencës, sipas VKM nr. 538, datë 26.05.2009, të ndryshuar;
- çdo dokument që subjekti kërkues gjykon se është i dobishëm për shqyrtimin e kërkesës së tij.

17.1.1 Licenca/ certifikata lëshohet, përveç rasteve kur:

- a) aplikanti është i paaftë të sigurojë shërbimin me pajisjet të disponueshme për atë shërbim.
- b) aplikanti nuk ka plotësuar kërkesat në lidhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi transportin rrugor dhe në veçanti kushtet dhe kërkesat lidhur me shërbimet e transportit ndërkombëtar të mallrave, ose ka kryer shkelje serioze të legjislacionit të transportit rrugor lidhur me rregullat e aplikueshme për kohën e drejtimit dhe periudhave të pushimit të drejtuesve të mjeteve.
- c) autoriteti kompetent, mbi bazën e analizave të detajuara, është i bindur që qëllimi kryesor i shërbimit nuk është transporti i mallrave ndërmjet dy pikave të ndryshme të vendosura në territorin shqiptar dhe/ ose në territorin e një shteti tjetër.

Autoriteti kompetent mund të refuzojë aplikimin vetëm mbi bazën e arsyeve të dhëna në këtë udhëzim.

17.2 Pezullimi dhe heqja e licencës/ certifikatës.

Në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, të ndryshuar dhe në zbatim të nenit 12, të ligjit 10081, datë 23.02.2009, të ndryshuar, autoriteti kompetent merr masa për pezullimin ose heqjen (revokimin) e licencës/ certifikatës nëse titullari nuk përmbush më kriteret e dhënies së këtij titulli apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

Konstatimi i mosplotësimit të kriterëve apo shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit.

Përpara marrjes së vendimit të heqjes, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ ose pezullimin e titullit (aktit administrativ), për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e vendimit për ripërmbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

Vendimi i pezullimit hiqet nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i ka plotësuar të gjitha detyrimet, sipas rastit.



Licenca/ certifikata, si rregull, revokohen/hiqen:

- a) kur rrethanat janë të tilla, që s' do të kishte kuptim apo mundësi për ripërbushjen e kriterëve apo ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga titullari, brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi.
- b) në rast të moszbatimit të urdhrave/vendimeve, brenda afateve të arsyeshme të pezullimit.
- c) në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga titullari dhe/ ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtrim të interesit publik, që garantohet nga titulli (akti administrativ), përkatës apo legjislacioni në fuqi.

Kur autoriteti kompetent vërteton që një subjekt i licencuar prej tij rrezikon plotësimin e kërkesave të pikës 6, ai duhet të njoftojë zyrtarisht personin përgjegjës/ përfaqësuesin ligjor ose drejtuesin e veprimtarisë së subjektit për këtë. Nëse autoriteti kompetent vëren se një ose më shumë prej kërkesave nuk plotësohet në vazhdimësi, me qëllim rregullimin e situatës, ai i jep subjektit mundësi të kufizuara kohore, si vijon:

- a) një periudhë kohore 6-9 muaj për marrjen në punë të një drejtuesi zëvendësues veprimtarie, në rastin kur mbajtësi i licencës nuk përmbush kërkesën e kompetencës profesionale dhe/ose ka lidhur kontratë me një drejtues veprimtarie, i cili:
  - i. ndërron jetë;
  - ii. ndërpret veprimtarinë për arsye të paaftësisë fizike ose mendore;
  - iii. ndërpret veprimtarinë për arsye të tjera;
  - iv. nuk plotëson kërkesën e reputacionit të mirë;
  - v. nuk plotëson më kërkesën e kompetencës profesionale.
- b) në rastin kur mbajtësi i licencës ka të punësuar dy ose më shumë drejtues veprimtarie, dhe ndonjëri prej këtyre drejtuesve humbet reputacionin e mirë, autoriteti kompetent i kërkon mbajtësit të licencës zëvendësimin e drejtuesit të veprimtarisë.
- c) një periudhë kohore 6–12 muaj, kur kërkesa e qëndrueshmërisë financiare nuk plotësohet, me qëllim demonstrimi që kjo kërkesë do të plotësohet përsëri në baza të qëndrueshme.

Licenca hiqet kur mbajtësi i licencës provohet se:

- a) ka paraqitur deklarime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat që kërkohen për lëshimin e licencës.
- b) nuk fillon veprimtarinë brenda afatit prej 3 muaj nga dita e lëshimit të licencës.
- c) kryen shkelje të rënda e të përsëritura në lidhje me kushtet e përshkruara në licencë.
- d) ka kryer shkelje serioze në përmbushjen e kërkesave të pikës 6.2.4 të këtij udhëzimi.

17.3 Procedurat për pezullimin ose heqjen e licencës ose certifikatës.

Autoriteti kompetent kur vendos për pezullimin ose heqjen e një licence/ certifikate:

- a) njofton mbajtësin e dokumentit përkatës për vendimin dhe arsyet, për të cilat ai ka marrë këtë vendim.
- b) pezullimi ose heqja e licencës/ certifikatës hyn në fuqi në fund të periudhës 21-ditore, duke filluar me ditën, që njoftimi i është dhënë mbajtësit të dokumentit përkatës.

Në rast se subjekti, brenda 30 ditëve pune nga dita e lëshimit, nuk tërheq licencën/ certifikatën dhe nuk paraqet provën e pagesës, autoriteti kompetent i vlerëson automatikisht të revokuar/të hequra, bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, të ndryshuar.

Mbajtësi i një licence ose certifikate mund të ankimojë vendimin për pezullimin ose heqjen e dokumentit përkatës. Ankimimi i drejtohet titullarit të autoritetit kompetent brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e pezullimit ose heqjes së licencës ose certifikatës.

Licenca ose certifikata anulohet edhe me kërkesë të vetë subjektit. Në transportin e mallrave autoriteti kompetent që ka lëshuar licencën ose certifikatën njoftohet të paktën dy muaj përpara ndërprerjes së veprimtarisë. Në kërkesën për anulimin e licencës ose certifikatës duhet të përcaktohet data e ndërprerjes së shërbimit dhe arsytet e kësaj ndërprerje.

## **18. Vendimet e autoritetit kompetent**

18.1. Autoriteti kompetent, në përputhje me ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, të ndryshuar merr vendime që përfshijnë refuzimin e një aplikimi, pezullimin ose heqjen e një licencë dhe deklarimin e papërshtatshëm të drejtuesit të veprimtarisë. Çdo vendim i marrë, shoqërohet me arsyetimin mbi shkaqet e refuzimit të aplikimit, pezullimit dhe heqjes së licencës.

18.2. Autoriteti kompetent refuzon kërkesën për licencim kur drejtuesi i veprimtarisë nuk ka plotësuar periudhën e rehabilitimit nga data, që i është komunikuar dënimi, ose kur dënohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, në përputhje me shkronjën “a” dhe “b”, të pikës 3.1, të kapitullit II të VKM nr. 325, datë 19.03.2008, të ndryshuar.

18.3. Para marrjes së një vendimi sipas pikës 17.2 më lart, për shkeljet e kryera nga subjekti ose drejtuesi i veprimtarisë, autoriteti kompetent, përveç organeve të kontrollit në rrugë sipas ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nëse është e nevojshme, grumbullon informacione që konsiderohen të rëndësishëm në veprimtarinë e transportit rrugor edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave apo institucione të tjera.

### **18.4 Penalitetet**

- a) Shkeljet e dispozitave të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë e me masa plotësuese të pezullimit të licencës (ose të certifikatës) dhe të lejes së qarkullimit.
- b) Transporti për të tretë dhe me qira kryhet kundrejt pagesës, me çmim/ tarifë që mbështetet në dispozitat e ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifën”, të ndryshuar. Mbajtësi i licencës, pas pagesës së klientit që përdor këtë shërbim, është i detyruar ta pajisë atë me faturë tatimore si provë e ekzistencës së një kontrate mes tyre. Mosrespektimi i kësaj dispozite dënohet me masë administrative sipas neneve 10, 68 dhe 71 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar.
- c) Cilido që shfrytëzon dhe përdor një mjet për:
  - i. përdorim vetjak për transportin e mallrave, me përjashtim të autovegurave për përdorim vetjak të përcaktuara në lejen e qarkullimit, pa licencën/certifikatën përkatëse ose nuk respekton kushtet dhe kufizimet e përcaktuara në lejen e qarkullimit, ndëshkohet me masë administrative sipas pikave 4 dhe 5, të nenit 82, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
  - ii. qiradhënie me drejtues mjete, që nuk është caktuar për një shërbim, për të cilin është regjistruar si i tillë, ndëshkohet me masë administrative sipas pikës 4, të nenit 84, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

## **18.5 Ankimimi**

Në rastin kur, autoriteti kompetent refuzon një kërkesë për pranimin në veprimtarinë e transportit rrugor, pezullon ose deklaron të papërshtatshëm për shkeljet e kryera nga ndërmarrja ose drejtuesi i veprimtarisë, personi i refuzuar ka të drejtë të ankimojë vendimin e marrë, në bazë të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe për procedura të mëtejshme, ai mund të ankohet në rrugë gjyqësore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

## **18.6 Dorëzimi i licencës, certifikatës së mjetit**

Pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë, licenca dhe/ ose certifikata për llogari të vet dorëzohen pranë autoritetit kompetent, i cili i ka lëshuar. Edhe në rastet e heqjes së licencës dhe/ ose certifikatës, brenda 10 ditë pune, dokumentet e mësipërme dorëzohen pranë autoritetit kompetent.

Për pezullimin e një licence/ certifikate, autoriteti kompetent njofton me shkrim mbajtësin e licencës/ certifikatës, që të dorëzojë këto dokumente brenda 10 ditë pune, nga dita e njoftimit.

Nëse, një subjekt nuk dorëzon pranë autoritetit kompetent, brenda afatit të përmendur në paragrafët e mësipërm, licencën ose certifikatën e pezulluar ose të hequr, ky i fundit njofton organet përgjegjëse të kontrollit në rrugë dhe të gjitha organet e tjera të interesuara për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit.

## **18.7 Pavlefshmëria dhe zëvendësimi i licencës dhe certifikatës**

Zëvendësimi i licencës dhe/ ose certifikatës bëhet me kërkesë të vetë titullarit të saj për rastet kur kërkohet ndryshim i ndonjë elementi përbërës të saj, ose deklarohet e humbur, e vjedhur, e shkatërruar apo kur është dëmtuar, (janë bërë të palexueshme specififikimet në të).

a) Nëse licenca/ certifikata ka humbur ose është vjedhur, subjekti informon menjëherë, brenda 7 ditë pune, me shkrim autoritetin kompetent.

Nëse licenca/ certifikata e humbur gjendet, subjekti e dorëzon atë tek autoriteti kompetent.

b) Kur licenca/ certifikata bëhet e palexueshme ose dëmtohet, ajo duhet të dorëzohet tek autoriteti kompetent.

Për rastet “a” dhe “b” të kësaj pike, autoriteti i licencimit/certifikimit brenda një afati 10-ditor, ka detyrimin të lëshojë një certifikatë operimi zëvendësuese me të njëjtin afat vlefshmërie, kundrejt pagesës.

Në rast të ndërrimit, zëvendësimit, shitjes ose dhënies me qira të mjetit ose kur mjete del jashtë përdorimit, apo kur subjekti pezullon ose mbyll veprimtarinë e transportit, është i detyruar të dorëzojë certifikatën/ at origjinale pranë autoritetit kompetent që e/ i ka lëshuar.

## **19. Periudha e vlefshmërisë së licencës/ kopjes së certifikuar dhe certifikatës**

Licenca/ kopja e certifikuar për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira lëshohet nga autoriteti kompetent, sipas VKM nr. 538, datë 26.05.2009, të ndryshuar, dhe është me afat deri në 10 vjet, (në përputhje me afatin e licencës komunitare të përcaktuar në Rregulloren 1072/2009).

Certifikatat e mjeteve për shërbimin për llogari të vet dhe mallrave të rrezikshme, lëshohen me afat nga 1 vit deri në 5 vjet, sipas kërkesës së subjekteve. Licenca e transportit (kopje e certifikuar/ njehsuar) dhe certifikata e mjetit në origjinal për shërbimin për llogari të vet/mallrave të rrezikshme, mbahen në mjet dhe janë objekt kontrolli dhe i paraqiten autoriteteve të kontrollit sa herë që u kërkohet.

## KAPITULLI VI

### 20. Dispozita transitorë dhe të fundit

20.1 Certifikatat të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për transport ndërkombëtar të mallrave:

- a) për të tretë ose me qira, kanë afat deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.
- b) për llogarit të vet do të vazhdojnë të jenë në fuqi deri në datën e vlefshmërisë/përfundimit të tyre.

20.2 Lidhjet bashkëlidhur këtij udhëzimi janë pjesë përbërëse e tij.

20.3 Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, dispozitat përkatëse të udhëzimit nr. 15, datë 24.7.2007, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, të cilat lidhen me transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, shfuqizohen.

20.4 Pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, modeli i licencës nr. 111 dhe modelet e certifikatave nr. 211 dhe nr. 212, të udhëzimit të ministrit nr. 20, datë 10.10.2007, “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar, shfuqizohen.

20.5 Licencat për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave të lëshuara përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të VKM nr. 538, datë 26.5.2009, të ndryshuar, lidhur me afatin dhe modelin e licencës, do vazhdojnë të jenë të vlefshme deri në një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletore Zyrtare”.

**MINISTËR**

**Belinda BALLUKU**

| Vendi _____                                  |  | K Ë R K E S Ë |      | më datë, ___/___/_____ |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
|--|--|---------------|------|------------------------|-----------|---------|-------|---------|------|-----|-------|---------|------|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|----|-----------|-----|-----|------|-----------|-----|-----|
| 1.   | Subjekti: ....., Adresa*: .....,<br>tel./fax ....., e-mail .....   |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 2.   | Vendi i kryerjes së veprimtarisë: .....  |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 3.   | Personi që paraqet kërkesën, (pronari / administratori / drejtuesi i veprimtarisë / personi autorizuar):<br>....., nr. ID/pasaportës .....   |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 4.   | Lloji i veprimtarisë për të cilën aplikohet: .....<br>(licencë dhe/ose certifikatë)<br>.....   |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 5.   | <p><b>Deklaroj që për ushtrimin e aktivitetit të mësipërm zotëroj në pronësi ose me qira mjetet me targat e mëposhtme: (kur kërkohet në veprimtarinë që aplikohet)</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nr.</th> <th>Targa</th> <th>Pronësi</th> <th>Qira</th> <th>Nr.</th> <th>Targa</th> <th>Pronësi</th> <th>Qira</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>1.</td> <td>AA XXX AA</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> <td>6.</td> <td>AA XXX AF</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> </tr> <tr> <td>2.</td> <td>AA XXX AB</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> <td>7.</td> <td>AA XXX AG</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> </tr> <tr> <td>3.</td> <td>AA XXX AC</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> <td>8.</td> <td>AA XXX AH</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> </tr> <tr> <td>4.</td> <td>AA XXX AD</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> <td>9.</td> <td>AA XXX AI</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> </tr> <tr> <td>5.</td> <td>AA XXX AE</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> <td>Etj.</td> <td>AA XXX AJ</td> <td>+/-</td> <td>+/-</td> </tr> </tbody> </table> <p style="text-align: right;">Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/></p> <p>Keni licencë dhe/ose certifikatë të mëparshme? <input type="checkbox"/></p> <p>Nëse po, specifikoni fushat: 1. _____ Nr. _____, datë ___/___/_____<br/>2. _____ Nr. _____, datë ___/___/_____<br/>3. _____ Nr. _____, datë ___/___/_____</p> |               |      |                        |           | Nr.     | Targa | Pronësi | Qira | Nr. | Targa | Pronësi | Qira | 1. | AA XXX AA | +/- | +/- | 6. | AA XXX AF | +/- | +/- | 2. | AA XXX AB | +/- | +/- | 7. | AA XXX AG | +/- | +/- | 3. | AA XXX AC | +/- | +/- | 8. | AA XXX AH | +/- | +/- | 4. | AA XXX AD | +/- | +/- | 9. | AA XXX AI | +/- | +/- | 5. | AA XXX AE | +/- | +/- | Etj. | AA XXX AJ | +/- | +/- |
| Nr.  | Targa  | Pronësi       | Qira | Nr.                    | Targa     | Pronësi | Qira  |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 1.   | AA XXX AA  | +/-           | +/-  | 6.                     | AA XXX AF | +/-     | +/-   |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 2.   | AA XXX AB  | +/-           | +/-  | 7.                     | AA XXX AG | +/-     | +/-   |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 3.   | AA XXX AC  | +/-           | +/-  | 8.                     | AA XXX AH | +/-     | +/-   |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 4.   | AA XXX AD  | +/-           | +/-  | 9.                     | AA XXX AI | +/-     | +/-   |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 5.   | AA XXX AE  | +/-           | +/-  | Etj.                   | AA XXX AJ | +/-     | +/-   |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 6.   | <p><b>Dokumente provuesuese dhe shoqëruese të dorëzuara**:</b></p> <p>6.1.....</p> <p>6.2.....</p> <p>6.3.....</p> <p>6.4.....</p> <p>6.5.....</p> <p>Etj.....</p>   |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 7.   | <p><b>Deklaroj nën përgjegjësinë time, në emër dhe për llogari të subjektit kërkues që përfaqësoj, se:</b></p> <p>a) Të dhënat e deklaruara dhe dokumentat e dorëzuara janë të vërteta dhe brenda periudhës së vlefshmërisë;</p> <p>b) Subjekti i transportit aplikues nuk ka asnjë pengesë ligjore për të ushtruar veprimtarinë e kërkuar;</p> <p>c) Subjekti njeh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e licencimit dhe/ose certifikimit.</p>   |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| 8.   | <p><b>Jam në dijeni që:</b> në rast se dokumentet për marrjen apo për të rinovuar licencën dhe/ ose certifikatën nuk dorëzohen _____*** ditë brenda afatit të përcaktuar, unë humbas të drejtën e marrjes së licencës dhe/ ose certifikatës.</p>   |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| <b>DEKLARUESI</b>                            |  |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| (Emër, Mbiemër dhe nënshkrimi i deklaruesit) |  | .....         |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |
| →  |  |               |      |                        |           |         |       |         |      |     |       |         |      |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |    |           |     |     |      |           |     |     |

**Shënim:**

1. Kur aplikanti është një person fizik ky formular plotësohet nga vetë personi. Kur aplikanti është person juridik, formulari plotësohet nga pronari/ administratori, drejtuesi i veprimtarisë që drejton aktivitetin e transportit të subjektit ose një person i autorizuar prej tyre.

2. Për çdo informacion shtesë për të cilin nuk ka vend për t'u paraqitur, përdorni një fletë të bardhë dhe pasi ta nënshkruani, bashkëlidhni këtij formulari.

\* Adresa e zyrës së subjektit (e deklaruar në QKB);

\*\*Listohen dokumentet përkatëse për aplikim;

\*\*\*Shënohet numri i ditëve sipas afatit të përcaktuar.

## VETËDEKLARIM

### I PRONARIT, ADMINISTRATORIT/ PËRFAQËSUESIT LIGJOR TË SUBJEKTIT

Bërë në .....

më datë \_\_\_ / \_\_\_ / \_\_\_\_

*Unë i nënshkruari* ..... pronar, administrator/ përfaqësues ligjor i subjektit ..... me seli në .....

***Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:***

- a) Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë, *nuk jam shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të transportit rrugor* (ose në rast se ka, deklaroj: “Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit gjyqësor/ gjykatën administrative/..... (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/dhe kam penalizim të licencës aktuale..... nga autoriteti përkatës ....., (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit)”.
- b) Subjekti ..... i regjistruar në organet tatimore me NUIS ....., regjistruar në Regjistrin Kombëtar pranë QKB nr. ...., datë ....., me objekt veprimtarie transport ndërkombëtar rrugor të mallrave, për të cilin kërkoj të licencohem, nuk është në proces falimentimi, nuk ka asnjë detyrim financiar ndaj të tretëve (Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tatimeve, Organeve të Pushtetit Vendor, etj).

***Deklaroj që njoh dhe zbatoj*** Ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 8, datë 31.12.2020, “Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave”.

### DEKLARUESI

.....

(emër, mbiemër dhe nënshkrimi)

**VETËDEKLARIM**  
**I DREJTUESIT TË VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT**

Bërë në .....

më datë, \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_

*Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:*

- a) **Jam i pajisur** me Certifikatën e Kompetencës Profesionale (CKP) për transport per transport ndërkombëtar rrugor të mallrave nr. ...., datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_.
- b) **Jam drejtues i veprimtarisë** të subjektit ..... me seli në ....., me objekt veprimtarie ....., për të cilin kërkon të licencohet.
- c) Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë, *nuk jam shpallur fajtor për shkelje të legjislacionit të transportit rrugor (ose në rast se ka)*, deklaroj: “Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit gjyqësor/ gjykatën administrative ..... (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/ dhe kam penalizim të CKP-së aktuale ..... nga autoriteti përkatës .....”, (shoqëruar me masën dhe motivin e penalizimit).
- d) **Kam lidhur kontratë** me këtë subjekt dhe mbaj përgjegjësi për:  
Mirëmbajtjen e mjeteve, verifikimin e kontratave dhe dokumenteve të transportit rrugor, veprimet financiare bazë, caktimin e ngarkesave ose shërbimeve të drejtuesve dhe mjeteve, si dhe verifikimin e procedurave të sigurisë.
- e) **Deklaroj që jam i punësuar** si drejtues veprimtarie në subjektet:  
1) .....  
2) .....  
3) .....
- f) **Njoh dhe zbatoj** ligjin nr. 8308 datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; VKM nr. 325, datë 19.3.2008, të ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 8, datë 31.12.2020, “Për kriteret, rregullat dhe dokumentacionin për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave”.

**Jam në dijeni që**, më lejohet të lidh kontratë dhe të drejtoj veprimtarinë e transportit deri në **tre** subjekte të ndryshme të vendosura në të njëjtin rreth me një numër të përgjithshëm maksimal prej **36** mjetesh, ose nëse jam punonjës i një subjekti, më lejohet të lidh kontratë edhe me një subjekt ose filial tjetër me seli brenda të njëjtit rreth me një numër të përgjithshëm maksimal prej **36** mjetesh të dy subjekteve.

**DREJTUESI I VEPRIMTARISË**

.....

(emër, mbiemër dhe nënshkrimi)

Shkeljet serioze/ më të rënda në vijim të nenit 6, pika 2), shkronja a), të Aneksit IV, të Rregullores (KE) nr. 1071/2009.

1. a) Tejkalon maksimum 6 ditë pune ose prej një marzh 25% ose më shumë.  
b) Tejkalon, gjatë periudhës ditore të punës, maksimumin e limitit të kohës ditore të drejtimit prej një marzhi 50% ose më shumë pa marrë një pushim/ndërprerje ose pa një periudhë pushimi të pandërprerë të paktën 4,5 orë.
2. Nuk ka një tahograf dhe/ ose kufizuesin e shpejtësisë, ose duke përdorur një pajisje të modifikuar e aftë të ndryshojë/ të ndërhyje regjistrimet e pajisjes regjistruese dhe/ ose kufizuesin e shpejtësisë ose fletën e regjistrimi të falsifikuara ose të dhëna të ngarkuara/transferuar nga tahografi dhe/ ose kartës së drejtuesit të mjetit.
3. Drejton mjetin pa patur një certifikatë të vlefshme të kontrollit teknik dhe/ ose me një difekt serioz, ndër të tjera sistemin e frenimit, sistemin e drejtimit, gomat, etj, që mund të krijojnë një rrezik të menjëhershëm për sigurinë rrugore.
4. Transporton mallra të rrezikshme që janë të ndaluara për transport ose transporton mallra të tilla në mënyrë të ndaluar ose të pa aprovuar ose pa identifikuar ato në mjet si mallra të rrezikshme, si rrjedhojë duke rrezikuar jetën ose mjedisin.
5. Transporton mallra pa patur leje drejtimi të vlefshme ose transporti kryhet nga një ndërmarrje transporti pa patur një licencë/ certifikatë të vlefshme.
6. Drejton mjetin me një kartë të drejtuesit të mjetit të falsifikuar, ose me një kartë të një drejtuesi, i cili nuk është mbajtësi i saj, ose që ka qenë mbajtur mbi bazën e një deklarimi fals dhe/ ose dokument të imituar.
7. Transporton mallra që kalojnë maksimumin e peshës së lejuar me ngarkesë deri në 20 % ose më shumë për mjetet pesha e lejuar me ngarkesë e të cilëve kalon 12 tonët, dhe 25 % ose më shumë për mjetet pesha e lejuar me ngarkesë e të cilëve, nuk kalon 12 tonë.



**Modeli Licencës**

[Sipas Rregullores (BE) nr. 1072/2009]

(Ngjyra Pantone blu e lehtë 290, format DIN A4 letër celuloze, 100 - 120 g/m<sup>2</sup>)

(Faqja e parë e licencës)

Stema

Autoriteti Kompetent  
(QKB)

LICENCË Nr. ....

LICENCE No. ....

(Ose / or)

KOPJE E CERTIFIKUAR Nr. ....

CERTIFIED TRUE COPY no. ....

**Për transport ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira***(For the international carriage of goods by road for hire or reward)*Kjo licencë i jep të drejtën () .....  
*(this licence entitles)*

për t'u angazhuar në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira me anë të çdo rruge, për udhëtime ose pjesë të udhëtimeve të kryera për të tretë ose me qira brenda territoreve të Palëve Kontraktuese, siç përcaktohet në Rregulloren (KE) nr. 1072/2009 mbi rregullat e përbashkëta për hyrjen në tregun ndërkombëtar të transportit rrugor dhe në përputhje me dispozitat e përgjithshme të kësaj licence.

*(to engage in the international carriage of goods by road for hire or reward by any route, for journeys or parts of journeys carried out for hire or reward within the territories of the Contracting Parties as laid down in Regulation (EC) no.1072/2009 on common rules for access to the international road haulage market and in accordance with the general provisions of this licence)*

Vërejtje të veçanta: .....  
*(Particular remarks:)*

Licenca është e vlefshme nga data: ..... deri më datë: .....  
*(Licence is valid from:)* *(To:)*

Lëshuar në: ..... më datë: .....  
*(Issued in:)* *(On:)*

.....  
Firma dhe vula e autoritetit kompetent  
*(Signature and stamp of the competent authority)*

<sup>(1)</sup> Emri i plotë ose emri tregtar dhe adresa e plotë e subjektit.  
*(Full name or business name and full address of the haulier)*

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Licenca lëshohet në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 1072/2009.

*(This licence is issued under Regulation (EC) No 1072/2009)*

Ajo i jep të drejtën mbajtësit të angazhohet në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për të tretë ose me qira me anë të çdo rruge për udhëtimet ose pjesët e udhëtimeve të kryera nga dhe për në territorin e Shqipërisë dhe, sipas rastit, sipas kushteve të përcaktuara këtu:

- ku pika e nisjes dhe pika e mbërritjes gjenden në dy vende të ndryshme, me ose pa tranzit nëpërmjet një ose më shumë vendeve (palë në marrëveshje) ose vendeve të treta;
- nga një vend në një vend të tretë ose anasjelltas, me ose pa transit përmes një ose më shumë vendeve (palë në marrëveshje) ose vendeve të treta;
- midis vendeve të treta me tranzit nëpër territorin e një ose më shumë vendeve dhe udhëtimet pa ngarkesë në lidhje me një transport të tillë.

*(It entitles the holder to engage in the international carriage of goods by road for hire or reward by any route for journeys or parts of journeys carried out from and to the territory of the Albania and, where appropriate, subject to the conditions laid down herein:*

- *where the point of departure and the point of arrival are situated in two different countries, with or without transit through one or more countries (parties in agreement) or third countries;*
- *from a country to a third country or vice versa, with or without transit through one or more countries (parties in agreement), or third countries;*
- *between third countries with transit through the territory of one or more countries, and unladen journeys in connection with such carriage.)*

Në rastin e transportit nga Shqipëria në një vend të tretë ose anasjelltas, kjo licencë vlen për atë pjesë të udhëtimit të kryer brenda territorit të vendeve, palë në marrëveshje. Ajo do të jetë e vlefshme në vendin e ngarkimit ose shkarkimit vetëm pas lidhjes së marrëveshjes së nevojshme ndërmjet Shqipërisë dhe vendit të tretë në fjalë në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 1072/2009.

*(In the case of carriage from Albania to a third country or vice versa, this licence is valid for that part of the journey carried out within the territory of the countries, parties in agreement. It shall be valid in the country of loading or unloading only after the conclusion of the necessary agreement between Albania and the third country in question in accordance with Regulation (EC) No 1072/2009.)*

Licenca është personale dhe jo e transferueshme.

Ajo mund të tërhiqet nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, veçanërisht kur mbajtësi:

- nuk ka respektuar të gjitha kushtet për përdorimin e licencës,
- ka dhënë informacion të pasaktë në lidhje me të dhënat e nevojshme për lëshimin ose zgjatjen e afatit të licencës

*(The licence is personal to the holder and is non-transferable.*

*It may be withdrawn by the competent authority, which issued it, notably where the holder has:*

- *not complied with all the conditions for using the licence;*
- *supplied incorrect information with regard to the data needed for the issue or extension of the licence.)*

Originali i licencës duhet të mbahet nga subjekti.

Një kopje e njehsuar/ certifikuar e licencës duhet të mbahet në mjet. Në rastin e një çifti të kombinuar të mjeteve licenca duhet të shoqërojë mjetin motorik. Licenca mbulon kombinimin e mjeteve të shoqëruara edhe në qoftë se rimorkio ose gjysmë-rimorkio nuk është regjistruar ose autorizuar të përdorë rrugët në emër të mbajtësit të licencës ose nëse është regjistruar ose autorizuar të përdorë rrugët në një shtet tjetër.

Licenca duhet të paraqitet me kërkesë të çdo zyrtari inspektues të autorizuar.

*(The original of the licence must be kept by the haulage undertaking.*

*A certified copy of the licence must be kept in the vehicle. In the case of a coupled combination of vehicles it must accompany the motor vehicle. It covers the coupled combination of vehicles even if the trailer or semi-trailer is not registered or authorised to use the roads in the name of the licence holder or if it is registered or authorised to use the roads in another country.*

*The licence must be presented at the request of any authorised inspecting officer.)*

Brenda territorit të Shqipërisë, vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe çdo vendi tjetër, palë në marrëveshje, mbajtësi i licencës duhet të respektojë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në fuqi të secilit vend, veçanërisht në lidhje me transportin dhe trafikun.

*(Within the territory of Albania, the Member States of the European Union and each other country, party in the agreement, the holder must comply with the laws, regulations and administrative provisions in force in that country, in particular with regard to transport and traffic.)*

### **Karakteristikat e sigurisë së licencës**


Licenca duhet të ketë të paktën dy nga karakteristikat e sigurisë si më poshtë:

- një hologram;
- fijet speciale në letër që bëhen të dukshme nën ndriçimin UV;
- të paktën një linjë mikroprinti (shtypja është e dukshme vetëm me një xham zmadhues e cila nuk riprodhohet nga makinat fotokopjuese);
- karaktere, simbole ose modele të prekshme;
- numërim i dyfishtë: numri serial dhe numri i lëshimit (të licencës);
- një sfond i sigurisë me motive të ndërthurura që shkëlqejnë (guilloche)\* dhe të shtypur me ngjyrat e ylberit.

\*



Faqja e parë e certifikatës, (Letër format A4, 100 - 120 g/m2, ngjyrë e verdhë)

|   |   |
|---|---|
|    | <b>Autoriteti Kompetent</b><br><i>Competent Authority</i><br>.....          |
| <b>CERTIFIKATË</b><br><i>CERTIFICATE</i>  |   |
| <b>PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE</b><br><b>PËR LLOGARI TË VET</b><br><i>FOR INTERNATIONAL CARRIAGE OF GOODS FOR OWN ACCOUNT</i>   |   |
| <b>I LËSHOHET SUBJEKTIT:</b><br><i>ISSUED TO THE ENTITY:</i>  |   |
| .....<br>Subjekti përgjegjës për operimet e transportit për llogari të vet<br><i>(Entity responsible for own account transport operation)</i>   |   |
| I nënshkruari: .....<br>Përgjegjës për subjektin, organizatën jo fitimprurëse ose tjerër (përshkruaj)<br><i>The undersigned:</i><br><i>Responsible for the entity, non profit-making-body or other (describe)</i>   |   |
| .....<br>Emër, mbiemër ose emri zyrtar, adresa e plotë<br><i>(Name, surname or trade name, full address)</i>  |   |
| vërteton që:<br><i>certifies that:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shërbimi i transportit i ofruar është për qëllime jo-tregëtare dhe jo-fitimprurëse;<br/><i>the transport service provided is non-profit-making and non-commercial;</i></li> <li>- transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse për subjektin;<br/><i>transport is only an ancillary activity for the person or entity;</i></li> <li>- mjeti me targa <b>AA XXX BB</b> është pronë e subjektit, ose i blerë me këste prej tij, ose është objekt i një kontrate afatgjatë qiramarrje;<br/><i>the vehicle with number plate <b>AA XXX BB</b> is the property of the person or entity or has been obtained by them on deferred terms or is subject of a long-term leasing contract;</i></li> <li>- mjeti do të drejtohet nga një punonjës i subjektit ose të personit nënshkruar, ose nga vetë personi nënshkruar ose nga një person i punësuar ose vënë në dispozicion të tyre, sipas një detyrimi kontraktual.<br/><i>the vehicle will be driven by a member of staff of the undersigned person or entity, or by the undersigned in person or by personnel employed by, or put at the disposal of, under a contractual obligation.</i></li> </ul> |   |
| .....<br>Nënshkrimi i personit ose përfaqësuesit<br><i>Signature of the person</i>  |   |
| .....<br><b>Periudha vlefshmërisë</b><br><i>(Period of validity)</i>  | .....<br><b>Vendi dhe data lëshimit</b><br><i>(Place and date of issue)</i> |
| .....<br><b>Nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent</b><br><i>Signature and stamp of the competent authority</i>  |   |

## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### GENERAL PROVISIONS

1. Në kuptimin e ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, transporti për llogari të vet nënkupton operimet e transportit të kryera nga një subjekt për qëllime jo-tregëtare dhe jo-fitimprurëse, me anë të cilës:

- veprimtaria e transportit është vetëm një veprimtari ndihmëse për subjektin;
- mjetet e përdorur janë pronë e subjektit, ose janë të blera me këste prej saj, ose janë objekt i një kontrate qiramarrjeje afatgjatë dhe drejtohen nga një punonjës i subjektit ose të personit nënshkruar, ose nga vetë personi nënshkruar ose nga një person i punësuar ose vënë në dispozicion të subjektit, sipas një detyrimi kontraktual.

*Within the meaning of the law no. 8308 of 18.03.1998, "On road transports", as amended, own account carriage means operations carried out for non-commercial and non-profit purposes by an entity, whereby:*

- transport activity is only an ancillary activity for the undertaking;
- the vehicles used are the property of the entity, or have been obtained by that entity on deferred terms, or have been the subject of a long-term leasing contract and are driven by a member of the staff of the undersigned person or entity, or by the undersigned in person or by personnel employed by, or put at the disposal of the undertaking under a contractual obligation.

2. Subjektet për llogari të vet lejohen të kryejnë operime transporti pa dallim me kusht që ato:

- janë të autorizuar në vendin e rregjistrimit të ndërmarrin transportin e mallrave në përputhje me kushtet e hyrjes në treg të përcaktuara në legjislacionin përkatës vendas;
- plotësojnë kërkesat ligjore mbi sigurinë rrugore për mjetet dhe drejtuesit e mjeteve sikundër përcaktohet në legjislacionin përkatës vendas.

*Own account carriers are permitted to carry out transport operations without discrimination provided that they:*

- are authorised in country of establishment to undertake carriage of goods in accordance with market access conditions laid down in relevant national legislation;
- meet legal requirements on road safety concerning drivers and vehicles, as laid down, in relevant national legislation.

3. Transportet e mallrave për llogari të vet i nënshtrohen sistemit të certifikatave.

*Carriage of goods for its own account are subject to a system of certificates.*

4. Certifikata i jep të drejtën mbajtësit të kryejë operime transporti ndërkombëtar rrugor të mallrave për llogari të vet. Ajo lëshohet nga autoriteti kompetent ku është rregjistruar mjeti dhe është e vlefshme gjatë gjithë udhëtimit, duke përfshirë udhëtimet transite.

*The certificate entitles the holder to carry out international transport operations for own account. It is issued by competent authority where the vehicle is registered and is valid for the entire journey, including any transit journeys.*

5. Pjesët përkatëse të kësaj certifikate plotësohen me shkronja që nuk fshihen në tre kopje nga personi ose përfaqësuesi i subjektit që kryen operacionin dhe nga autoriteti kompetent. Një kopje e certifikatës mbahet në zyrën e autoritetit kompetent, e cila e ka lëshuar atë dhe një kopje mbahet nga subjekti. Drejtuesi i mjetit mban kopjen origjinale ose të certifikuar në bordin e mjetit përgjatë gjithë udhëtimit. Ajo i paraqitet autoriteteve të zbatimit të ligjit me kërkesën e tyre.

*The relevant parts of this certificate are completed in indelible letters in triplicate by the person or the representative of the entity carrying out the operation and by the competent authority. One copy of certificate is kept by the administration and one copy by the person or entity. The driver keeps the original or a certified true copy on board the vehicle for the entire the duration of any international journeys. It is presented to the enforcement authorities on request.*

6. Certifikata është e vlefshme për një periudhë maksimumi 5 (pesë) vjet.

*The certificate is valid for a maximum of 5 (five) years.*